



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО
KOMUNA E VITISË - ОПШТИНА ВИТИНА

Prqimje - Prilidim Matirang 29-06-2016

Nr. i Urgencit Org. Nivel	Numri i Aktit	Siç është P. i. i. i.	Vlera Vendoset
	<u>01-013/528</u>		



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12. paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenit 36.paragrafi 36.2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, dhe nenit 6.1.2 të Memorandumit të Mirëkuptimit nr 02-013/945 të datës 03.08.2012 për implementimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm për Sllatinë epërme, Sllatinë e Poshtme, Sadovinë e Qerkezëve, Sadovinë e Jerlive dhe Trestenik të Komunës së Vitisë, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 27.04.2016 aprovon këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 100,203,00€ PËR PËRFUNDIMIN E PROJEKTIT NDËRTIMI I SISTEMIT TË UJËSJELLËSIT PËR FSHATRA: SLLATINË E EPËRME, SLLATINË E POSHTME, SADOVINË E QERKEZËVE, SADOVINË E JERLIVE DHE TRESTENIK TË KOMUNËS SË VITISË

Neni 1.

Kuvendi i Komunës së Vitisë APROVON Vendimin për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej **100,203,00€** me shkronja (njëqind mije e dyqind e tri euro) për implementimin e Aneks Memorandumit të Mirëkuptimit për implementimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm për fshatrat: Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Poshtme, Sadovinë e Qerkezëve, Sadovinë e Jerlive dhe Trestenik të Komunës së Vitisë.

Neni 2.

Mjetet nga neni 1 i këtij Vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2016 nga kodi buxhetor për investime kapitale të Komunës së Vitisë.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 4.

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në Veb faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit,
2. Shërbimit të Kuvendit,
3. Drejtorisë për Financa, dhe
4. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

